



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 3

2002

Shkurt

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 15, datë 28.1. 2002	Për krijimin e Fondit për riaftësimin e veprave ujtitëse.....	53
Vendim i KM nr.18, datë 28.1.2002	Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të Albtransport sh.a.-së.....	57
Vendim i KM nr. 19, datë 28.1.2002	Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale.....	58
Vendim i KM nr. 23, datë 28.1.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.564, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e familjeve të nxënësve dhe studentëve dhe fëmijët që pranohen në shtëpitë e fëmijës, në Institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë dhe në Institutin e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore”.....	59
Vendim i KM nr.28, datë 28.1.2002	Për trajtimin financiar të ushtarakëve dhe punonjësve civilë në Forcat e Armatosura, që dërgohen për diagnostikim dhe kurim jashtë shtetit	60

Vendim i KM nr.29, datë 28.1.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 7.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar””, me ndryshimet përkatëse.....	60
Vendim i KM nr.30, datë 28.1.2002	Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive që do të ndërtojnë dhe përdorin instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre.....	62
Vendim i KM nr.31, datë 28.1.2002	Për një shtesë në vendimin nr.66, datë 24.2.2000 të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore".....	65
Vendim i KM nr.37, datë 28.1.2002	Për organizimin dhe funksionimin e repartit të inspektim-shpëtim në miniera.....	65

VENDIM
Nr. 15, datë 28.1. 2002

PËR KRIJIMIN E FONDIT PËR RIAFTËSIMIN E VEPRAVE UJITËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8593, datë 30.3.2000 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe IFAD-it për programin e zhvillimit të zonave malore" dhe të ligjit nr. 8781, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Fondit të riaftësimit të veprave ujitëse për realizimin e investimeve në sistemet ujitëse dhe për mbështetjen, për ngritjen, funksionimin dhe konsolidimin e shoqatave të përdoruesve të ujit, në kuadër të programit të zhvillimit të zonave kodrinore-malore të vendit. Veprimtaria e këtij Fondi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statutin, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Veprimtaria dhe asetet fikse të njësisë së koordinimit të Projektit "Rehabilitimi i veprave të vogla ujitëse", pas vlerësimit nga një grup i pavarur kontrolli financiar, t'i kalojnë në formë granti, Fondit të riaftësimit të veprave ujitëse, sipas marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet këtij Fondi dhe Ministrisë së Financave e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

STATUTI I FONDIT TË RIAFTËSIMIT TË VEPRAVE UJITËSE

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe me vendim të Këshillit të Ministrave krijohet Fondacioni "Fondi i riaftësimit të veprave ujitëse" (në vazhdim do t'i referohemi si "Fondi" ose FRVU). Ai është një fondacion që njihet si person juridik dhe ushtron aktivitetin e tij që nga dita e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Fondacioni emërohet "Fondi i riaftësimit të veprave ujitëse" dhe që më poshtë do të quhet "Fondi" është person juridik. Këshilli i Ministrave është themeluesi i Fondit.

Fondi do ta kryejë veprimtarinë e tij bazuar në këtë statut, në manualin e procedurave dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Veprimtaria e Fondit shtrihet në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Neni 3

Selia qendrore do të jetë në qytetin e Tiranës në adresën: Rruga "Sami Frashëri", godina e ish-Institutit të Studimeve dhe Projektimeve Hidroteknike. Selia mund të ndryshojë me vendim të Bordit Drejtues.

Fondi mund të hapë zyra edhe në rrethe të tjera të Shqipërisë.

Neni 4

Objektivi i përgjithshëm i Fondit është realizimi i investimeve në infrastrukturën rurale, kryesisht në riaftësimin e veprave ujitëse dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së investimit nëpërmjet nxitjes së ngritjes dhe funksionimit të grupeve të përfituesve të tij (shoqatave të përdorimit të ujit).

Neni 5

Me qëllim realizimin e objektivave, Fondi do të kryejë aktivitetet që janë përcaktuar dhe janë në përputhje me procedurat e specifikuar në Manualin e procedurave administrative, financiare dhe teknike të miratuara nga Bordi Drejtues. Fondi mund të kryejë dhe aktivitete të tjera, të cilat janë në përputhje me qëllimin kryesor të Fondit dhe janë të miratuara nga Bordi Drejtues.

Neni 6

Ky fondacion krijohet për një afat kohor të përcaktuar. Sigla e tij është _____

KAPITULLI II BURIMET FINANCIARE TË FONDIT

Neni 7

Burimet financiare të Fondit përbëhen nga:

- transferimi i asetëve të Njësisë së Koordinimit të Projektit "Rehabilitimi i veprave të vogla ujitëse";
- kontributet materiale dhe financiare shtetërore nga programet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe organizata jofitimprurëse;
- grante dhe donacione nga individë dhe organizma brenda dhe jashtë vendit;
- burime të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 8

Burimet e Fondit depozitohen në llogari bankare në monedha shqiptare e të huaja.

Të gjitha tërheqjet nga llogaritë bankare të Fondit do të bëhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Manualin e procedurave financiare dhe të vërtetuara nga dokumentet e duhura.

Llogaritë e Fondit do të mbahen dhe raportohen në përputhje me standardet shqiptare të kontabilitetit.

KAPITULLI III STRUKTURA ORGANIZATIVE E FONDIT

Neni 9

Organet drejtuese të Fondit janë:

- Bordi Drejtues,
- Këshilli Ekzekutiv.

Neni 10

Bordi Drejtues, i cili në vazhdim do të cilësohet "Bordi", do të përbëhet nga:

1. Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Ushqimit,
2. përfaqësuesi i Kryeministrisë,
3. Drejtori i Zyrës së Programeve Bujqësore në MBU,
4. përfaqësuesi i Ministrisë së Financave,
5. përfaqësuesi i Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë,
6. përfaqësuesi i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore,
7. Drejtori i Drejtorisë së Ujrave në MBU.

Neni 11

Bordi do të kryesohet nga Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Ushqimit dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të deleguar prej tij.

Neni 12

Bordi është organi më i lartë drejtues i Fondit dhe ka këto detyra:

1. Miraton politikën dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë së Fondit;
2. miraton Buxhetin vjetor të Fondit;
3. miraton raportin vjetor financiar të Fondit;
4. autorizon Drejtorin Ekzekutiv të negociojë dhe hyjë në marrëveshje me Qeverinë Shqiptare dhe institucionet financiare ndërkombëtare e lokale të nevojshme për të arritur objektivat e Fondit;
5. autorizon Drejtorin Ekzekutiv të negociojë për të kontraktuar huatë e kërkuara nga Fondi për veprime të tij;
6. miraton dokumentet e nevojshme për zbatimin e këtij statuti;
7. miraton ndryshimet në statutin e Fondit, në përputhje me nenin 22 të këtij statuti;
8. zhvillon mbledhje të zakonshme çdo tre muaj dhe mbledhje të jashtëzakonshme, sa herë që është e nevojshme, me kërkesë të kryetarit;
9. analizon raportet e revizioneve të kryera mbi aktivitetin e Fondit.

Neni 13

Mbledhjet do të zhvillohen me praninë e të paktën 2/3 të anëtarëve të Bordit dhe vendimet merren me shumicën e votave.

Neni 14

Anëtarëve të Bordit iu lejohet rimbursimi i kostove të arsyeshme të udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit, si dhe të shpenzimeve të tjera që lidhen me pjesëmarrjet e tyre direkt në aktivitetet e Fondit. Anëtarët e Bordit mund të marrin honorare për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Bordit, siç është përcaktuar në Rregulloren e Bordit Drejtues.

Neni 15

Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga:

- Drejtori Ekzekutiv,
- drejtuesit e departamenteve e njëjse.

Neni 16

Këshilli Ekzekutiv ka këto detyra:

- Hyn në marrëdhënie kontraktuale me subjektet e ndryshme të interesuara. Në këto raste vendimet e Këshillit Ekzekutiv merren me shumicë votash. Nëse votat do të jenë të barabarta, vota e Drejtorit Ekzekutiv është vendimtare.

- Ndjek dhe analizon realizimin e objektivave të Fondit.

Neni 17

Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Bordi Drejtues. Anëtarët e tjerë të Këshillit Ekzekutiv emërohen nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 18

Drejtori Ekzekutiv është autoriteti më i lartë ekzekutiv i Fondit dhe kryen këto detyra:

- Është përfaqësues i ligjshëm i Fondit;
- drejton veprimtarinë e Fondit dhe zbatimin e vendimeve të Bordit;
- drejton burimet e Fondit;
- nënshkruan marrëveshjet me Qeverinë dhe donatorë të ndryshëm joqeveritarë;
- zgjedh dhe emëron personelin;
- nënshkruan kontratat përkatëse për shërbimet profesionale dhe teknike;
- përgatit dhe i propozon Bordit rregulloret për veprimtaritë e Fondit;
- nënshkruan kontrata me revizionues të jashtëm;
- cakton pagën e punonjësve, në përputhje me Manualin e procedurave administrative dhe financiare të Fondit, si dhe modifikon shkallët e nivelit të pagave, në përputhje me meritat e tyre, brenda buxhetit vjetor të aprovuar;
- kryen të gjitha detyrat e tjera që i ngarkon ky statut dhe rregulloret e tij përkatëse.

Neni 19

Marrëdhëniet e punës me personelin, përveç rasteve të përmendura në këtë statut, rregullohen në bazë të procedurave administrative, financiare dhe teknike të Fondit, si dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 20

Shpenzimet operative për asistencën teknike dhe kualifikimin, për pajisjet, mjetet e transportit dhe shpenzimet e tjera për përshtatjen, mirëmbajtjen e për qirramarrjen e mjediseve të punës financohen nga burimet e Fondit.

KAPITULLI V REVIZIONIMI

Neni 21

Fondi është objekt i revizionimit të jashtëm, nga audit kombëtar dhe ndërkombëtar të pavarur, të pranueshëm për kontraktuesit. Raportet e revizionimit të jashtëm do të shqyrtohen nga Bordi Drejtues për veprimet ligjore përkatëse.

BASHKIMI DHE NDARJA E FONDACIONIT

Neni 22

Bashkimi dhe ndarja e Fondit do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Pasuria e këtij Fondi pas likuidimit të tij t'i jepet një organizate tjetër, e cila ka një objekt të njëjtë ose të ngjashëm me qëllimin e krijimit të këtij Fondi.

KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE TË PËRKOHSHME

Neni 23

Bordi Drejtues i Fondit ka të drejtë të bëjë ndryshime në këtë Statut, në përputhje me dispozitat në fuqi, me përjashtim të neneve 1, 4, 8, 9 dhe 22. Ndryshimi i neneve 1, 4, 8, 9 dhe 22 bëhet me miratimin e Këshillit të Ministrave dhe pëlqimin e donatorëve.

Neni 24

Aktiviteti i Fondit do të zgjatet për aq kohë sa do të sigurohen burime financimi.

VENDIM Nr. 18, datë 28.1.2002

PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I RISTRUKTURIMIT TË ALBTRANSPORT SH.A.-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit që mbeten të papunë nga procesi i ristrukturimit të Albtransport sh.a., nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi deri në çastin e dhënies me koncesion të shoqërisë, të trajtohen financiarisht për një periudhë dyvjeçare në masën 100 për qind të pagës bazë mujore, të shtesës së vjetërsisë në punë dhe për sigurimet e detyrueshme, në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Kjo periudhë e pagesës për këta punonjës të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që kanë qenë të punësuar në këtë shoqëri deri në çastin e kalimit të saj në konservim, pa ndërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit, e që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

4. Fondet financiare të nevojshme për kryerjen e pagesës për periudhën dyvjeçare dhe për sigurimet e detyrueshme të përballohen nga Albtransport sh.a.

Pagesat e punonjësve të bëhen nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse, duke bërë kalimin e fondeve të mësipërme në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Transportit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 19, datë 28.1.2002

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE
DHE TË REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale është Drejtoria Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti të përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit (shërbimi veterinar) drejtojnë dhe zbatojnë, për çdo zonë që ato mbulojnë, sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale nëpërmjet kontratave që do të lidhin me specialistë dhe teknikë privatë, veterinerë dhe zooteknikë.

3. Specialistët e kontraktuar privatë, për punën e kryer, të paguhen nga fermerët me 100 (një qind) lekë për çdo kafshë të matrikuluar dhe plotësimin e formularëve respektivë.

4. Blerja e bazës materiale të nevojshme për fillimin e kësaj veprimtarie të përballohet nga programi PHARE, sipas memorandumeve financiare AL 9805, datë 28 tetor 1998 dhe AL 9912, datë 24 nëntor 1999. Fermerët të paguajnë bazën materiale për krijimin e fondit kundërparti, i cili të depozitohet në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të përcaktojë çmimin e bazës materiale që do të paguajnë fermerët, në bazë të ofertës financiare të entit furnizues të kontraktuar.

Fondi kundërparti të përdoret për blerjen në vazhdimësi të materialeve për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, sipas udhëzimit përkatës, të hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Organet e qeverisjes vendore dhe, sipas nevojës, institucionet publike bashkëpunojnë dhe mbështesin drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit për zbatimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 23, datë 28.1.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.564, DATË 13.10.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE TË NXËNËSVE DHE STUDENTËVE DHE FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË DHE NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, të shkronjës “c” të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.564, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:
“Nxënësve dhe studentëve u jepet bursë ose gjysmëbursë çdo vit. Këto fonde të përballohen nga Buxheti i Shtetit, përkatësisht për nxënësit, nga granti i miratuar për pushtetin vendor dhe për studentët, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.”.
2. Pas pikës 12 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Për vitin akademik 2001-2002, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës t’i shtohen 100 bursa për arsimin e lartë, të cilat përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.”.
3. Pas pikës 14 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
“Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave shtesë të jetë data 1 mars 2002.”.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 28, datë 28.1.2002

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË USHTARAKËVE DHE PUNONJËSVE CIVILË NË FORCAT E ARMATOSURA, QË DËRGOHEN PËR DIAGNOSTIKIM DHE KURIM JASHTË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 29 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për ushtarakët e Forcave të Armatosura dhe pjesëtarët e familjes së tyre, bashkëshorti a bashkëshortja dhe fëmijët, të cilët përfitojnë diagnostikim dhe kurim falas jashtë shtetit, në bazë të protokoll-marrëveshjeve me ushtritë e huaja, shpenzimet e udhëtimit të përballohen në masën 100 për qind nga shteti.

2. Kur ushtarakët rezervë dhe punonjësit civilë të Forcave të Armatosura dërgohen për diagnostikim dhe kurim jashtë shtetit, shpenzimet e udhëtimit të përballohen në masën 70 për qind nga shteti dhe 30 për qind nga ata vetë.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Ushtarakët aktivë dhe punonjësit civilë të Forcave të Armatosura, si dhe ushtarakët në rezervë nuk përfitojnë nga zbatimi i pikës 5 të vendimit nr.159, datë 20.4.1991 të Këshillit të Ministrave “Për kujdesin mjekësor të shtetit për të sëmurët që dërgohen jashtë shtetit”.

5. Pika 1 e këtij vendimi i shtrin efektet që nga data 1.1.2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 29, datë 28.1.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.190, DATË 3.5.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7874, DATË 7.11.1994 “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR””, ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, ndryshuar me ligjet nr.8526, datë 23.9.1999 dhe nr.8664 datë 18.9.2000, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimet nr.467, datë 4.9.1995; nr.2, datë 10.1.1996; nr.562, datë 2.12.1999; nr.353 datë 7.7.2000 dhe nr.114, datë 8.3.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikat 1, 19 dhe 21 pas shprehjes “Departamenti i veteranëve dhe i invalidëve të luftës...” fjala “ e ushtrisë” të hiqet.

2. Pika 9 të riformulohet si më poshtë vijon:

“9.a. Të internuarit në kampet nazifashiste të përqendrimit, përveç shpërblimit të veteranit, sipas shkronjës “a” të pikës 7, të marrin edhe shpërblimin e invalidit të Luftës, të grupit të parë.

b. Të internuarit në kampet e internimit, brenda dhe jashtë vendit, shpërblehen me dyfishin e masës së shpërblimit që përfitojnë ish-të burgosurit në burgjet nazifashiste, që kanë qëndruar mbi 6 muaj në këto burgje.”.

3. Në pikën 14 masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit Qendror të “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare nga 900 (nëntëqind) lekë bëhet 2 000 (dy mijë) lekë për pjesëmarrjen në mbledhje, për specialistët nga 540 (pesëqind e dyzet) lekë bëhet 700 (shtatëqind) lekë për ditë pune.”.

4. Pas pikës 22 shtohen pikat si më poshtë vijojnë:

“23.a. Komisioni Qendror i “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ia njeh këtë status veteranit, që ka marrë shpërblimin prej 100 lekësh në muaj dhe që ka vdekur para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 dhe i jep familjes së tij dëshminë “Familje veterani”.

b. Dëshmia “Familje veterani” i jepet edhe familjes së veteranit, pas vdekjes së tij, i cili e ka pasur “Statusin e veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

24. Forma dhe përmbajtja e dëshmisë miratohen nga Ministri i Mbrojtjes.

25. Përbërja e Komisionit Qendror të “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të jetë sipas funksioneve organike, të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

26. Komisioni Qendror i “Statusit të veteranit” të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe stafi teknik i tij të vazhdojnë veprimtarinë edhe për vitin 2002.

Deri më 30 korrik 2002 të përfundojnë praktikat për dhënien e “Statusit të veteranit”.

Deri më 30 nëntor 2002 të përpunohet, inventarizohet, përgatitet e dorëzohet i tërë dokumentacioni në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura.”.

5. Vendimi nr.540, datë 9.10.1995 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Komisionit Qendror dhe të komisioneve të rretheve për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare” shfuqizohet.

6. Efektet financiare të përballohen nga fondet e caktuara për veteranët në buxhetin e vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA
E PËRBËRJES SË KOMISIONIT QENDROR
PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VETERANIT TË LANC-IT TË POPULLIT SHQIPTAR

1. Zëvendësministri i Mbrojtjes	Kryetar
2. Drejtuesi i Strukturës përkatëse për Veteranët dhe Invalidët e Luftës dhe Dëshmorëve të Atdheut	Nënkryetar
3. Përfaqësuesi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore	Nënkryetar
4. Një Jurist i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mbrojtjes	Anëtar
5. Drejtori i Arkivit Qendror të Ushtrisë	Anëtar
6. Një Specialist i Arkivit Qendror të Shtetit	Anëtar
7. Një përfaqësues i Ministrisë së Rendit	Anëtar
8. Një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë	Anëtar
9. Një përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale	Anëtar
10. Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë	Anëtar
11. Tre përfaqësues të Organizatave të Veteranëve	Anëtar
12. Dy përfaqësues të Organizatës së Invalidëve të Luftës dhe të Ushtrisë	Anëtar

VENDIM
Nr. 30, datë 28.1.2002

**PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË
SHOQËRIVE QË DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN INSTALIME BREGDETARE PËR
TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT
DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të publikojë zonat e përcaktuara për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, sipas masterplanit të vendosjes së depozitave bregdetare, të instalimeve portuale dhe infrastrukturës rrugore në hapësirat e përcaktuara në vendimin nr.251, datë 24.4.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e studimit "Përcaktimi i hapësirave të përshtatshme për ndërtimin e depozitave bregdetare, të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre", si dhe sipërfaqet për ndërtimin e tyre, miratuar me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 KRRTSH-së.

a) Publikimi të bëhet 3 herë radhazi në 2 gazeta të përditshme, me tirazh të madh, si dhe në median elektronike.

b) Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të vërë në dispozicion të shoqërive të interesuara informacionin e nevojshëm për hartimin e projekteve, kundrejt një pagese prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh.

2. Shoqëritë e interesuara, që kërkojnë të ndërtojnë dhe të përdorin instalimet bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre në sipërfaqet e truallit të përcaktuara në masterplanin e miratuar me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të KRRTSH-së, të paraqesin kërkesën në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Skemat e zonës ku kërkohet të ndërtohet instalimi bregdetar, si dhe sipërfaqen e saj në m2;
- projektidenë për kapacitetin depozitues dhe vlerësimin financiar për instalimet bregdetare që do të ndërtohen;

- dokumentin bankar për kredibilitetin financiar për përballimin e vlerës së investimit të parashikuar;

- vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik si shoqëri anonime;

- certifikatën për regjistrimin në zyrën e tatimeve dhe dokumentin e NIPT-it për personat juridikë;

- dokumentacionin e duhur për të treguar përvojën në fushën e ndërtimit dhe të përdorimit të instalimeve bregdetare për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre.

3. Për vlerësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë, sipas përcaktimit në pikën 2 të këtij vendimi, të ngrihet komisioni i vlerësimit të kërkesave, me këtë përbërje:

- Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	3 anëtarë
- Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit	1 anëtar
- Ministria e Transportit	1 anëtar
- Ministria e Financave	1 anëtar
- Ministria e Mjedisit	1 anëtar
- Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	1 anëtar

Kryetari i Komisionit caktohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Mënyra e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit, Ministrisë së Transportit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, i cili duhet të dalë brenda 30 ditëve nga miratimi i këtij vendimi.

5. Komisioni i vlerësimit të kërkesave mbledhet brenda një periudhe kohore 15-ditore pune nga data e paraqitjes së kërkesës dhe bën verifikimin e dokumentacionit dhe të ofertës përkatëse, si dhe të zonës ku kërkohet të ndërtohet instalimi bregdetar, në mbështetje të masterplanit miratuar me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të KRRTRSh-së.

a) Kur, pas verifikimit, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria është i rregullt, komisioni pranon kërkesën dhe i propozon Ministrinë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhënien e autorizimit për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e depozitave dhe të instalimeve në zonën e kërkuar. Dhënia e autorizimit bëhet brenda 5 ditëve nga data e mbledhjes së komisionit të vlerësimit të kërkesave.

b) Kur, pas verifikimit, rezulton se dokumentacioni nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2, komisioni hedh poshtë kërkesën dhe i kthen subjektit dokumentacionin përkatës, së bashku me argumentimin për këtë vendim.

6. Për rastet kur për të njëjtën sipërfaqe paraqiten më shumë se një kërkesë, të cilat i plotësojnë kërkesat e pikës 2, komisioni i vlerësimit të kërkesave përcakton sipërfaqen që i ofrohet secilit, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzimin e përbashkët, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Autorizimi duhet të përmbajë:

a) emrin e shoqërisë që paraqet kërkesën, numrin e vendimit të gjykatës dhe NIPT-in e saj;

b) të drejtën për të investuar në zonën përkatëse, në përputhje me masterplanin e miratuar me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 nga KRRTRSH-ja, duke identifikuar territorin për investim. Procedurat e dhënies së sheshit dhe lejes së ndërtimit duhet të respektojnë ligjin nr.8405 datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", si dhe ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

c) afatin kohor brenda të cilit duhet të përfundojë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejes së koncesionit deri në paraqitjen e tij në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për procedim të mëtejshëm. Ky afat, në çdo rast, nuk mund të jetë më shumë se 5 (pesë) muaj.

8. Shoqëria e pajisur me autorizim duhet të paraqesë në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi, dokumentacionin zyrtar, të shqyrtuar dhe miratuar nga institucionet dhe organet e përcaktuara në pikat 6 dhe 7 të vendimit nr.358, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare, për transportim+depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", si dhe dokumentin e pronësisë për truallin ku do të ndërtohet ose marrëveshjen me pronarin për marrjen në përdorim ose me qira të truallit, për aq kohë sa do të jepet leja për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare.

9. Në rastin kur trualli mbi të cilën do të ndërtohen instalimet bregdetare është pronë publike, subjekti e merr atë në përdorim me kontratë qiraje, sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, me afat deri në 30 vjet, me kushtin që në rastin kur nuk merret leja e ndërtimit në KRRTRSh kjo kontratë është e pavlefshme.

10. Në rastin kur toka mbi të cilën do të ndërtohen instalimet bregdetare është pronë private dhe subjektet nuk arrijnë në marrëveshje me pronarët, atëherë subjekti i interesuar mund të paraqesë kërkesën për shpronësimin për interes publik, në zbatim të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

11. Në rastin kur shoqëria vazhdon më tej procedurat për marrjen e lejes së koncesionit, një kopje e autorizimit i bashkëlidhet dokumentacionit që Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit i përcjell KRRTRSH-së.

12. Dhënia e lejes së koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare bëhet kundrejt pagesës nga shoqëritë përkatëse, e cila derdhet në llogarinë e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Tarifat e pagesës për lejen e koncesionit janë:

- për leje koncesioni për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për nënproduktet e naftës (përfshirë gazin e lëngshëm) 2 000 000 lekë;

- për leje koncesioni për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për gazin e lëngshëm 1 000 000 lekë.

13. Infrastruktura portuale e instalimeve bregdetare (pontili dhe/ose bankina me tubacionet dhe pajisjet përkatëse) për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Durrës, në sipërfaqet e miratuara me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të KRRTRSH-së ndërtohet dhe administrohet nga "Autoriteti Portual Durrës" sh.a.

14. Fondet e nevojshme për ndërtimin e kësaj infrastrukture të parashikohen nga "Autoriteti Portual Durrës" sh.a. në programin e zhvillimit të vitit 2002.

15. Infrastruktura portuale e instalimeve bregdetare (pontili dhe/ose bankina me tubacionet dhe pajisjet përkatëse) për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Vlorë në sipërfaqet e miratuara me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të KRRTRSH-së rindërtohet dhe administrohet nga "Porti Detar Vlorë" sh.a.

16. Projektet për ndërtimin e infrastrukturës portuale të instalimeve bregdetare (pontili dhe/ose bankina me tubacionet dhe pajisjet përkatëse) të realizohen nga institucionet shkencore, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Transportit.

17. Marrëdhëniet për përdorimin e infrastrukturës portuale dhe të instalimeve bregdetare rregullohen me marrëveshje ndërmjet organit përkatës që i administron ato dhe shoqërive të licencuara.

18. Ngritjen në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të njësisë për trajtimin dhe përpunimin e dokumentacionit për marrjen e lejes së koncesionit për instalimet bregdetare dhe ndjekjen e zbatimit të saj.

19. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, Ministria e Transportit, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 31, datë 28.1.2002

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.66, DATË 24.2.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KËSHILLAT MBIKQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.1.1997, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Paragrafi i dytë i pikës 3 të vendimit nr.66, datë 24.2.2000 të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore", të formulohet si më poshtë vijon:

"-Shpërblimi për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, për kryetarin, të jetë në masën 30 për qind e pagës mujore të drejtorit të shoqërisë dhe në masën 20 për qind për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, ndërsa për shoqëritë anonime shtetërore, që e kanë dhënë pasurinë tërësisht me qira apo emfiteozë, kryetari i këshillit mbikëqyrës shpërblehet në masën 7 për qind të pagës mujore të drejtorit të shoqërisë dhe anëtarët e tjerë të këtij këshilli në masën 5 për qind të pagës mujore të drejtorit të shoqërisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 37, datë 28.1.2002

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REPARTIT TË INSPEKTIM - SHPËTIMIT
NË MINIERA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 14 të ligjit nr.8741, datë 15.2.2001 "Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare", të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat e caktimit të pagave të punës" dhe të nenit 7 të ligjit 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Reparti i Inspektim-Shpëtimit në Miniera (RISHM) është person juridik, publik, buxhetor në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i specializuar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregullave, për një rregjim normal të punës së personave, juridikë dhe fizikë, në veprimtarinë minerare.

2. RISHM-i drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Kryeinspektori dhe inspektorët e qendrës përbëjnë nivelin qendror të organizimit, ndërsa inspektorët e zonave përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga kryeinspektori.

3. Inspektorë zone të jenë 8 veta, të vendosur në Tiranë, Durrës, Dibër, Shkodër, Korçë, Berat, Elbasan dhe Vlorë. Ndarja në zona përfshin gjithë territorin e vendit, sipas organizimit të bërë nga RISHM-i, në përputhje me numrin e subjekteve, private dhe shtetërore, që kryejnë veprimtari minerare.

4. RISHM-i e ka qendrën në Tiranë. Inspektorati në qendër plotësohet me mjedise nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ndërsa inspektorët e zonave plotësohen me mjedise pune, sipas propozimeve të prefekturave që mbulojnë zonat përkatëse.

5. Të drejtën e ushtrimit të kontrollit e kanë të gjithë inspektorët e RISHM-it, të cilët pajisen me dokument identifikimi nga sektori i shërbimit teknik të ministrisë.

RISHM-i funksionon sipas rregullores së brendshme, të miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

6. Kontrolli kryhet brenda orarit të veprimtarisë së subjekteve, por mund të kryhet edhe jashtë orarit të punës, vetëm me urdhër me shkrim të kryeinspektorit. Gjithsesi, gjithmonë në prani të një përfaqësuesi të shoqërisë apo të personit fizik, i cili zotëron ose përdor minierën apo karrierën.

7. Rezultatet e kontrollit pasqyrohen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga inspektori që ushtron kontroll dhe nga përfaqësuesi i subjektit. Ky i fundit ka të drejtën e shënimit të vërejtjeve, nëse ka, në procesverbal.

Në rastin kur përfaqësuesi i subjektit nuk pranon të marrë pjesë në procesin e kontrollit apo të nënshkruajë sipas kushteve të përcaktuara më sipër, atëherë inspektori vendos shënimin "nuk pranon të nënshkruajë", duke e bërë kështu procesverbalin të vlefshëm.

Në rastin kur kërkohet heqja e lejes, një kopje e procesverbalit i dërgohet organit që e ka lëshuar atë.

8. Për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, kryeinspektori mbledh "Komisionin e shqyrtimit të gjobave të RISHM-it". Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët propozohen nga RISHM-i dhe miratohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen me rregullore të brendshme të RISHM-it.

9. Ndaj masave të marra nga inspektorët bëhet ankim me shkrim në komisionin e shqyrtimit të gjobave të RISHM-it, brenda 5 ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit. Vendimi i këtij të fundit duhet të jepet brenda një afati 10 ditor nga data e mbërritjes së ankesës.

10. Në vendimin nr.75, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për numrin e punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2001" të parashikohet shtesa e numrit të punonjësve prej 4 vetësh. Struktura organizative e RISHM-it është sipas pasqyrës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", në lidhjen II-25 "Niveli i pagave të punonjësve të RISHM-it" të bëhen ndryshimet sipas pasqyrës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 e këtij vendimi të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2002, miratuar për RISHM-in.

13. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

14. Vendimi nr.157, datë 8.6.1961 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Pasqyra nr.1

STRUKTURA ORGANIZATIVE E RISHM-IT

Nr.	Emërtimi	Profesioni	Numri
1	Komandant (Kryeinspektor) i RISHM	Ing.miniere	1
II	Grupi i inspektimit		17
1	Zv/komandant dhe përgjegjës i grupit të inspektimit	Ing.miniere	1
2	Inspektor në qendër	Ing.miniere, elektrik, mekanik, kimist	6
3	Inspektor zonal	Ing.miniere	8
4	Laborant	Teknik i mesëm	1
5	Shofer	Shofer	1
III	Grupi i shpëtimit		22
1	Komandant grupi	Ing.miniere	1
2	Komandant skuadre	Ing.miniere	2
3	Shpëtues	Specialist miniere	10
4	Mekanik i pajisjeve të shpëtimit	Elektromekanik	2
5	Mekanik i riparimit të pajisjeve të shpëtimit	Elektromekanik	1
6	Instruktor i përgatitjes të shpëtuesve	Ing.miniere	1

7	Mjek i gupit të shpëtimit	Mjek	1
8	Operator gatishmërie	Teknik	1
9	Shoferë të automjeteve të gatishmërisë	Shofer	3
IV	Dega ekonomike, sektori ndihmës		12
1	Kryetar dege	Ekonomist i lartë	1
2	Ekonomist furnizimi	Ekonomist i lartë	1
3	Arkivist, arkëtar	Ekonomist i mesëm	1
4	Magaznier	Ekonomist i mesëm	1
5	Mekanik, kolaudator automjesh	Mekanik	2
6	Shofer	Shofer	1
7	Pastruese	Punëtore	1
6	Roje	Punëtor	4

Pasqyra nr.2 (Lidhja II-25)

NIVELI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË RISHM-TIRANË

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi
1	Komandanti (kryeinspektor) i RISHM	B3
2	Zv/komandant i RISHM dhe përgjegjës i grupit të inspektimit	B5
3	Inspektor i RISHM, komandant i grupit të shpëtimit	C1

Nr.	Emërtimi i punonjësit	Klasa	Shtesë për funksion (grupi)
1	Kryetar i degës ekonomike	X	3
2	Komandant skuadre shpëtimi	VIII-IX	3
3	Instruktur i përgatitjes së shpëtuesve, mjek i grupit të shpëtimit, shpëtuesve, mekanik i pajisjeve të shpëtimit	VIII-IX	
4	Ekonomist furnizimi, mekanik i riparimit të pajisjeve të shpëtimit, mekanik kualadator i automjeteve, shofer i automjeteve të gatishmërisë	VI-VII	
5	Laborant i provave të litarëve të çelikut, shofer	V-VI	
6	Operator gadishmërie, arkivist, magazinier	III-IV	
7	Roje objekti, pastruese, punëtor	I-III	

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 14.2.2002
Doli nga shtypi më 15.2.2002

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Edlor"
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë